



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1288/Prot.

Tiranë, më 24 /11/2016

VENDIM

Nr. 86, datë 24 / 11 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. Dorian Matlija ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1288 Prot., datë 17.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresat e datës 12.10.2016 ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan t’i vihen në dispozicion informacioni si më poshtë:

Në lidhje me shkresën nr.156/16prot:

1. Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;
2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
3. Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfutur ato;
5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në lidhje me shkresën nr.157/16prot:

1. Kopje të strukturës organizative;
2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;
3. Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;
4. Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.

Në lidhje me shkresën nr.158/16prot:

1. *Kopje të planeve strategjike të punës;*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;*
3. *Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;*
4. *Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;*
5. *Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;*
6. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
7. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
8. *Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Në lidhje me shkresën nr.159/16prot:

1. *Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;*
2. *Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.*

Me shkresën nr. 1080 Prot., datë 25.10.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kthyer përgjigje mbi informacionin e kërkuar në lidhje me shkresën nr.156/16 Prot., nr.157/16 Prot dhe shkresën nr. 159/16 Prot., datë 12.10.2016.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit në lidhje me shkresën nr. 158/16 Prot., datë 12.10.2016, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim.

Në këto kushte ankuesi Qendra “Res Publica” kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës informacionin mbi: *planet strategjike të punës; të dhënat për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara; dokumentat që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit; mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik; raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera; procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 1288 Prot., datë 17.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (shkresa nr. 158/16 Prot, datë 12.10.2016), brenda datës 06.12.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 24.11.2016.

